

VISA INFINITE

VISA INFINITE është një kartë krediti që ofrohet si një produkt financiar elitari i lidhur me një paketë përfitimesh premium dedikuar për një kategori prestigjioze klientesh. Visa Infinite rankohet në nivelin më të lartë të hierarkisë së produkteve karta duke u karakterizuar nga një shërbim perfekt, qasje individuale dhe akses në një sërë privilegjesh.

Klientëve Premium individ që do të aplikojnë në Bankën Credins për kartën Visa Infit, u jepet akses në fondet që kanë në llogarinë e kartës sipas limitit të overdraftit të aprovuar. Limitet për kartat Visa Infit do të jenë në nivelet më të larta të aprovuara në Bankë deri në 25'000 euro, dhe mbi këtë limit do të ofrohet me garanci hipotekë.

Karta e kreditit VISA Infit vec funksionaliteteve standarte si gjithë kartat e tjera të kreditit, si dhe benefitit të ofrimit të një limiti të lartë përdorimi, përfshijnë dhe një gamë të gjerë benefitesh të cilat i ofrohen klientëve si një paketë e vetme.

Si të njiheni me përfitimet tuaja?

1. VISA CHATBOT

Visa Chatbot është një platformë komunikimi ku mund të njiheni me të gjitha benefitet e kartës suaj dhe të merrni asistencë personale.

Regjistrimi është **falas** për të gjithë mbajtësit e kartës në

<https://www.visasoutheasteurope.com/albania/chatbot.html> ose në platformat si me poshtë:

- Viber Chatbot VISA
- Telegram Chatbot VISA [Launch @VisaConciergeBot](#)

Pas regjistrimit, ju do të merrni udhëzimet për çdo benefit (si aktivizohet, ku aplikohet, çfarë dokumentesh duhen, etj.).



Viber



Telegram

2. Akses Premium në Aeroporte – DRAGONPASS & FAST TRACK

DragonPass ofron akses të palimituar, falas, për ju dhe deri në **dy vizitorë shoqëruar** në një rrjet me mbi 1'200 salla private biznesi në aeroporte në gjithë botën me shërbime të përfshira si pije, ushqim, pritje komode, wi-fi etj. Aksesin në Dragon Pass ofron edhe shërbimin Fast Track pa limit, për të gjithë kartëmbajtësit në kalimin e formaliteteve të aeroportit me prioritet dhe pa pritje në rradha.

Për të kontrolluar hyrjet por edhe për aplikim të anëtarësimit digjital në program, mund të regjistroheni në Chatbot Visa Concierge ose në aplikacionin Visa Airport Companion app.

Si të përdorni ofertën për Lounge:

1. Regjistrohuni në **Visa Concierge Chatbot** dhe kërkoni shërbimin në menu përkatëse Lounge, aty ju dërgohet Karta juaj digjitale, ose
2. Shkarkoni aplikacionin **Visa Airport Companion** në Google apo App Store vendosni të dhënat tuaja personale dhe ndiqni udhëzimet për të përfunduar regjistrimin në aplikacion
3. Për të aksesuar Lounge, duhet të paraqesni kartën tuaj digjitale të anëtarësimit/ QR code

Si të përdorni ofertën për Fast Track:

1. Aksesoni Visa ChatBot
2. Shkoni ne menu Visa Travel dhe klikoni Fast Track International
3. Përzgjidhni shtetin dhe aeroportin që do përdorni
4. Plotësoni të dhënat e kërkuara
5. Merrni QR code

Për më shumë informacion <https://www.visasoutheasteurope.com/albania/offers-n-privileges.html>
<https://www.visairportcompanion.ca/home?lang=en>

3. VISA INSURANCE – Sigurimi Ndërkombëtar i Udhëtimit

Programi i sigurimit nga VISA ofron një gamë benefitesh sigurimi të lidhura me mbulimin e shpenzimeve mjekësore, sigurimin e blerjeve apo të fluturimit dhe bagazheve në udhëtim.

Si funksionon sigurimi?

1. Sigurimi fillon automatikisht nëse përpara fluturimit ju:
 - Paguani me kartën tuaj për biletën e kthimit
 - Keni rezervuar dhe paguar me kartën tuaj Visa INFINIT për akomodimin para udhëtimit
 - Paguar fluturimin dhe akomodimin me kartën tuaj përpara udhëtimit
2. Për udhëtime në vendin tuaj të rezidencës duhet të siguroheni që përpara udhëtimit të:
 - Rezervoni për minimumi dy net dhe me një distancë të paktën 100 km nga vendi juaj i rezidencës
 - Emri në rezervimin e biletës dhe akomodimit duhet të përputhet me emrin e titullarit të kartës

Cfarë përfshihet?

- Shëndeti në udhëtim - Asistencë mjekësore në cdo vend të botës për mbulimin e shpenzimeve mjekësore emergjente në udhëtim për të gjithë individët kartëmbajtës nën 80 vjec, bashkëshortin/ten dhe fëmijët në ngarkim nën moshën 18 vjec, deri në vlerën maksimale prej 2.5 mln dollarë.
- Sigurimi i udhëtimit - sigurimi në aksidente me makinë me qera; rimbursim për humbje apo vonesa mbi 4 orë të bagazheve; rimbursim për shpenzime ushqimi dhe akomodimi për raste vonesa fluturimi, humbje apo anulime të fluturimit për shkaqe të mbuluara
- Sigurimi Sportit - sigurimi i 58 aktiviteteve të jashtme dhe sportive
- Sigurimi Blerjeve - sigurimin e blerjeve të bëra me kartën VISA INFINITE deri në 360 ditë nga dita e blerjes në rast humbje, vjedhje apo dëmtimi aksidental.

Si të aksesoni portalin?

- <https://cardholderbenefitsonline.com>
- Logohuni duke vendosur numrin e kartës tuaj Visa Infnit
- Klientët kanë akses të plotë në policën e sigurimit, Termat dhe Kushtet, Kontaktet apo si të nisin një formularë kërkesë/ankese
- Për të nisur një Claim (Formular Kerkese) pasi të logoheni në portal, sigurohuni të mbani faturat, raporte mjekësore apo cdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm për t'i ngarkuar në portal, dhe me pas prisni deri në marrjen e vendimit.

Për më tepër informacion mund të drejtoheni në Visa Concierge apo në link si me poshte:

<https://www.visasoutheasteurope.com/albania/offers-n-privileges.html>

<https://cardholderbenefitsonline.com>

4. VISA CONCIERGE – Shërbimi pa Kufi

Shërbimi Concierge përfshin një skuadër me asistentë personal të cilët ofrojnë suport online cdo ditë. Akses në një platformë komunikimi 24/7, pa pagesë, ku kartëmbajtësi mund të informohet dhe të marrë asistencë të personalizuar për planifikime udhëtimi, aktivitete apo shërbime të tjera interesi si më poshtë:

- Aktivitete ditore (alarm, takime, njoftime, rezervime, rekomandime, referenca)
- Udhëtime (Lounge Key, bileta avioni, hotele, shërbime aeroporti, makina me qera)
- Sigurimi (sigurimi në udhëtim, sigurimi makinës, vonesa në bagazhe, vonesa në fluturime)
- Digital & e-Commerce (oferta nga tregtarë të ndryshëm, transport, blerje bileta për evente & aktivitete)
- Suport 24/7 (asistence legale, mjekësore, informacione, edukim) Shërbim global i dedikuar për mbajtësit e kartës Visa Infinite.

Si të kontaktoni Concierge:

- Pasi të jeni regjistruar në **Visa Chatbot**, klikoni **Concierge**
- Me email: visa@concierge.link
- Me telefon: + 380 44 300 05 03 (English)

5. Global Client Support Service (GCSS)

Shërbimi i suportit të klientit ofron suport online 24/7 me 27 qendra kontakti në gjithë botën për të asistuar të gjitha kërkesat e klientëve në cdo gjuhë.

- tBllokim karta të humbura / vjedhura 24/7
- Zëvendësim emergjent i kartës brenda 24 orëve
- Tërheqje emergjente e fondeve në 27'000 vende në botë
- Suport call center 24/7 në **+1 303 967 1090**
- Asistencë dhe konsulencë mjekësore për cdo pyetje lidhur me destinacionin e fluturimit
- Asistencë dhe konsulencë ligjore

Shërbimi mund të aksesohet në:

- ✓ Visa Chatbot/Concierge
- ✓ visa@concierge.link
- ✓ + 380 44 300 05 03

6. Paketë 9 GB roaming

Ofrohet paketë roaming 3 herë në vit i vlefshëm për 127 shtete. Cdo 14 ditë do të mund të gjeneroni një kod QR për aktivizimin e shërbimit (3 QR codes për e-sim) për të gjithë klientët kartëmbajtës Visa Infinite.

Si të përfitoni:

1. Aksesoni Visa ChatBot
2. Selektoni Visa Travel në menu dhe më pas ROAMING
3. Do të merrni një QR Code dhe instruksione për shërbimin
4. Shijoni GB ekstra kudo ku ndodheni

7. Zbritje në tregtarë partnerë

Të gjitha transaksionet blerje me kartën VISA INFINITE përfitojnë zbritje të caktuara në një sërë partnerësh. Këto oferta janë në fusha të ndryshme dhe objekt ndryshimesh sipas afateve dhe fushatave që do të marketohen.

- Akomodim (AGODA deri në 12%, 15% IHG Hotels & Resort; deri 50% BookingBash)
- Makina me qera (SIXT; HERTZ; AVIS deri në 35%)
- Tregtar lokal

Lidhur me ofertat mund të gjeni informacione të rifreskuara në:

<https://www.visasoutheasteurope.com/albania/offers-n-privileges.html>